

RREGULLORE
E PROCEDURAVE TE BLERJES SE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA SHOQERIA
OSHEE SH.A. TEK SHOQERITE E LICENSUARA PER TREGTIMIN E ENERGJISE
ELEKTRIKE

Neni 1 - Baza ligjore

Kjo Rregullore hartohet ne zbatim te;

- nenit 19, gërma “1” nenit 62, pika 2, nenit 69, germa “ë”, te Ligjit Nr. 43/2015, date 28.05.2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”.

Neni 2 - Objekti dhe qellimi

1- Objekti i kesaj rregulloreje eshte percaktimi i procedurave per blerjen e energjise elektrike nga shoqeria OSHEE sh.a. tek shoqerite e licensuara per tregtimin e energjise elektrike.

2- Qellimi i kesaj rregulloreje eshte:

- a. te percaktoje procedura eficente dhe praktike per OSHEE sh.a. per blerjen e energjise elektrike nga tregtaret;
- b. te siguroje blerje te energjise elektrike me kosto sa me te ulet;
- c. te nxise pjesemarrjen e Tregtareve ne procesin e blerjes se energjise elektrike;
- d. te nxise konkurrencen ne procesin e blerjes se energjise elektrike;
- e. te siguroje transparence si dhe nje trajtim te barabarte per te gjithë tregtaret, pjesemarres ne procedurat e blerjes se energjise elektrike.

Neni 3- Parimet

Procedurat e blerjes se energjise elektrike sipas kesaj rregulloreje do te realizohen ne perputhje me parimet e procedurave me negocim, parimet e barazise, konkurrences, transparences dhe ruajtjes se konfidencialitetit.

Neni 4 -Percaktime

Ne kete rregullore termat e perdorur me poshte do te kene kuptimin:

1. ERE do të thotë Enti Rregullator i Energjisë, përgjegjës për sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, I cili funksionon në përputhje me ligjet e cituara më sipër dhe aktet nënligjore në fuqi

2. Autoriteti Bleres/Bleresi: nenkupton OSHEE sh.a. e cila kryen perkatesisht aktivitetin e shperndarjes se energjise elektrike si dhe te Furnizuesit te Sherbimit Universal sipas licensave se leshuara nga Enti Rregullator i Energjise.

3. Titullari i Autoritetit Bleres: do te thote Administratori OSHEE sh.a. ose personi i autorizuar prej tij ne menyre te dokumentuar.

4. OSHEE/FSHU: nenkupton Operatorin e Shperndarjes se Energjise Elektrike/ Furnizuesin e Sherbimit Universal, i cili ne baze te Ligjit Nr. 43/2015, date 28.05.2015 “Per

Sektorin e Energjise Elektrike eshte personi juridik, pergjegjes pwr operimin e sigurt, tw besueshwm dhe tw efektshwm tw rrjetit tw shkwrndarjes si edhe te shitjes me pakice te energjise elektrike per klientet tarifore.

5. Blerje e energjise elektrike: do te thote kalimi ne sasi dhe ne kohe i energjise elektrike nga Tregtaret e energjise elektrike dhe/ose Bursat energjetike, tek Autoriteti Bleres kundrejt pageses dhe kushteve te tjera te percaktuara ne kontraten perkatese te shit-blerjes, dhe sipas procedurave te percaktuara ne kete rregullore.

6. Tregtar i energjise elektrike: do te thote cdo person juridik/shoqeri vendase apo e huaj qe ushtron aktivitet te licensuar, per tregtimin e energjise elektrike me shumice.

7. Kerkesa/Ftesa per oferte: do te thote dokumenti zyrtar qe Autoriteti Bleres u drejton Tregtareve te energjise elektrike per paraqitje te ofertave, **hartuar ne formen e parashikuar ne kete rregullore**

8. Ofertues:do te thote Tregtari i **licencuar** I energjise elektrike,qe paraqet nje Oferte pas dergimit te kerkeses/fteses per Oferte nga Autoriteti Bleres.

9. Oferte: do te thote teresia e dokumenteve, dhe korrespondences te derguar me email, poste ose dorazi, si dhe/ose nepermjet platformes elektronike dhe te administruara nga Autoriteti Bleres sipas rregullave ne fuqi, me ane te te cilave nje Ofertues dergon ne pergjigje te nje "Ftese per Oferte" te shpallur dhe derguar nga Autoriteti Bleres.

10. Terma komerciale: eshte teresia e elementeve qe kane te bejne me kushtet teknike, sasine, cmimet e shit-blerjes, levrimin, kapacitetet e interkonjeksionit si dhe tarifat apo pagesat e tjera qe shoqerojne transaksionin e blerjes.

11. Kapacitetet e transmetimit/interkonjeksionit: jane kapacitetet e interkonjeksionit te cilat sigurohen nga OSHEE sh.a. dhe/ose nga tregtaret, per te mundesuar blerjen e energjise elektrike.

Neni 5 -Pergjegjesite

Autoriteti Bleres eshte pergjegjes per percaktimin e grafikut te fuqise ne MW dhe te energjise ne MWh perkatesisht (ne kapacitet dhe ne sasi te energjise elektrike) qe ai do te bleje sipas procedurave te percaktuara ne kete rregullore, si dhe per percaktimin e periudhes kohore dhe programit te livrimit te saj qe duhet te llogaritet duke marre parasysh percaktimet e Modelit te Tregut te Energjise Elektrike, Rregullave te Tregut te Energjise Elektrike si dhe Kodeve te Funkcionimit te Rrjetit.

Neni 6 -Zbatimi

Procedurat e blerjes se energjise elektrike te percaktuara ne kete rregullore do ti zbatoje **OSHEE/FSHU:**

- a. kur nevojat e OSHEE/FSHU per plotesimin e kerkeses per energji te konsumatoreve/klienteve tarifore nuk plotesohen nga KESH;
- b. per mbulimin e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes.
- c. dhe/ose ne rastet e zbatimit te instruksioneve te OST sh.a ne lidhje me shmangien e devijimeve dhe/ose sigurise se sistemit;
- d. nw rastin e blerjes se energjise elektrike ne kushte emergjente, perfshire dhe pa u kufizuar ne avarite e ndodhura ne njesite shperndarese te energjise elektrike.

Neni 7- Perjashtime te vecanta

7.1 Procedurat e blerjes se energjise elektrike te percaktuara ne kete rregullore nuk zbatohen per blerjen e saj nga Prodhuesit Vendas te licensuar qe kane nje marreveshje shitblerjeje sipas legjislacionit ne fuqi.

7.2 Procedurat e blerjes se energjise elektrike te percaktuara ne kete rregullore nuk zbatohen ne rastet e blerjes se energjise elektrike ne menyre direkte (pa perfshire ndermjetesit) nga bursat energjetike.

7.3 Procedurat e blerjes se energjise elektrike te percaktuara ne kete rregullore nuk zbatohen ne rastet e blerjes se energjise elektrike nga OSHEE sh.a nepermjet pjesemarrjes ne procedurat e shitjes se energjise elektrike qe organizohen nga KESH sh.a.

Neni 8 -Kontratat per blerjen e energjise elektrike

1. Blerja e energjise elektrike nga ana e Autoritetit Bleres prej Tregtareve te energjise elektrike/shoqerive qe ofrojne shitje te energjise elektrike, ne kuptim te nenit 5 te ketyre rregullave, kryhet mbi baze te kontratave qe lidhen si rrjedhoje e procedurave dhe kritereve te percaktuara ne kete rregullore.

2. Kontratat do të hartohen në përputhje me dispozitat e “Marrëveshjes kuadër lidhur me lëvrimin dhe pranimin e energjisë elektrike”, të hartuar nga Federata Europiane e Tregtarëve të Energjisë, me dispozitat detyruese përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe në bazë të negociatave mes palëve.

Neni 9 -Ftesa per blerje te energjise elektrike

1- Per cdo blerje te energjise elektrike, ne perputhje me kete Rregullore, Titullari i Autoritetit Bleres, harton ftesen me termat perkatese per blerjen e energjise elektrike. Ftesa permban te pakten:

- Sasine e energjise elektrike ne MWh qe kerkohet per tu blere;
- Grafikun ditor te livrimit;
- Kohezgjatjen e livrimit ne dite/jave/muaj;
- Periudhen e plote kohore te livrimit te energjise elektrike te percaktuar ne marredheniet kontraktuale (shit-blerjes);
- Siguruesin e kapaciteteve te transmetimit;
- Piken e livrimit te energjise elektrike;
- Kerkesat per kualifikimin ne proceduren e blerjes sic parashikohet ne nenin 10;
- Kriterin e vleresimit te ofertave;
- Date, oren dhe vendin ne te cilin do te hapen dhe njekohesisht lexohen ofertat;
- Ftesen per te gjitha perfaqesuesit e shoqerive pjesemarrrese si dhe te publikut te

interesuar qe te marrin pjese ne hapjen dhe leximin e ofertave;

- Vlefshmerine e ofertave;
- Kushtet e pagesave;
-

2- Autoriteti Bleres do te publikoje ne faqen e tij zyrtare te internetit cdo ftese per blerje te energjise elektrike ne te njejten dite qe fton kompanite e listuara prej tij, per te marre pjese ne procesin e blerjes se energjise.

Neni10- Dokumentacioni Ligjor – Administrativ

1- Cdo shoqeri e licensuar per tregtimin e energjise elektrike ne Shqiperi dhe/ose ne nje vend anetar te Traktatit te Komunitetit te Energjise qe deshiron te marre pjese ne, proceduren e blerjes se energjise elektrike duhet te paraqese prane Autoritetit Bleres, dokumentacionin e nevojshem administrativ qe verteton aftesine e tij ligjore si dhe ate te tregtimit te energjise elektrike, nga institucionet kompetete te shteteve perkatese ku jane rregjistruar dhe ushtron aktivitetin apo ka seline e tij qendrore si dhe nga institucionet e shtetit shqiptar si me poshte vijon:

a. Dokumentacionin qe verteton rregjistrimin e shoqerise ne rregjistrat perkates tregtar gjyqesor te shtetit ne te cilin shoqeria eshte krijuar apo rregjistruar.

b. Licensen per tregtimin e energjise elektrike te leshuar nga ERE per tregtaret te cilet jane krijuar apo rregjistruar ne Republiken e Shqiperise, apo shtetet perkatese per ata Tregtare te energjise elektrike te cilet jane krijuar apo rregjistruar jashte Republikes se Shqiperise.

c. Dokumentacionin e leshuar nga institucionet kompetente te shtetit **jo me heret se 3 muaj** nga momenti I depozitimit, te cilet vertetojne se:

- Tregtari apo **perfaqesuesit ligjore te shoqerise** nuk jane denuar me vendim gjykate te formes se prere per shkelje penale
- Tregtari apo **perfaqesuesit ligjore te shoqerise** nuk jane denuar me vendim gjykate te formes se prere per ceshtje qe lidhen me aktivitetin e tregtimit te energjise elektrike;

2- Ne baze te ketyre dokumentave, Autoriteti Bleres do te hartoje listen e shoqerive te perzgjedhura qe do te ftohen prej tij ne procedurat e blerjes se energjise elektrike qe do te zhvillohen ne vazhdimesi. Ne momentin e perfshirjes se shoqerise se interesuar ne listen e shoqerive te perzgjedhura, Autoriteti Bleres eshte i detyruar qe ti dergoje ftese per pjesemarrje te gjitha shoqerive te perfshira ne kete liste. Lista botohet brenda dates 15 Dhjetor te cdo viti ne faqen e internetit te Autoritetit Bleres, si dhe ne te gjitha rastet e perditimit.

3- Ky informacion do te kerkohet cdo vit nga te gjitha Tregtaret me te cilet Autoriteti Bleres bashkepunon ose ka marredhenie kontraktore gjate viteve te fundit. Ky informacion duhet te paraqitet brenda dates 30 nentor te cdo viti dhe do te jete i vlefshem per vitin pasardhes.

4- Tregtaret qe shprehin per here te pare interesin e tyre per te marre pjese ne procedurat e blerjes se energjise elektrike te zhvilluar nga Autoriteti Bleres, te cilet nuk kane depozituar dokumentacionin ligjor te kerkuar me pare do te paraqesin dokumentacionin e mesiperm prane ketij te fundit se bashku me shprehjen e interesit. Autoriteti Bleres vendos brenda dhjete ditesh pune ne lidhje me kerkesen e paraqitur. Autoriteti Bleres do te perfshije ne

listen e shoqerive te perzgjedhura te gjitha shoqerite qe shprehin interes dhe qe paraqesin te gjitha dokumentat e kerkuara.

5- Pas perfshirjes ne listen e shoqerive qe Autoriteti Bleres i dergon ftese per pjesemarrje ne procedurat e blerjes, shoqerite pjesemarrrese paraqesin ne proceduren e blerjes vetem formularin e ofertes me te dhenat e kerkuara.

6. Autoriteti Bleres nuk mund te refuzoje/perjashtoje shoqerite qe kane paraqitur dokumentacionin e plote te kerkuar per te marre pjese ne procedurat e blerjes se energjise elektrike. Cdo perjashtim nga keto procedura/mos dergimi i fteses per te marre pjese ne keto procedura, mund te kryhet vetem pas miratimit nga Bordi i ERE.

Neni 11 -Kriteret e vleresimit te ofertave

Ne ftesen per blerje qe Autoriteti Bleres i drejton shoqerive te perfshira ne listen e shoqerive te perzgjedhura qe do te ftohen prej tij ne procedurat e blerjes se energjise elektrike, percakton kriterin kryesor te vleresimit te ofertave te kualifikuara sipas kriterëve te kualifikimit te percaktuara ne kete rregullore, i cili ne kete rast do te jete cmimi/njesi dhe/ose cmimet/njesi me te uleta, te cilat rezultojne te tilla ne perfundim te procedures se vleresimit te ofertave. Ne rastet e procedurave me objekt blerjen e energjise elektrike perkundrejt (me reference) ndaj nje burse energjetike, kriteri i vleresimit do te jete koeficienti dhe/ose vlera me e favorshme, perkundrejt burses energjetike, per Autoritetin Bleres.

Neni 12 -Komunikimi i Autoritetit Bleres me shoqerite pjesemarrrese ne procedurat e blerjes se energjise elektrike

I gjithë komunikimi i Autoritetit Blerës me shoqëritë pjesëmarrëse në procedurat e blerjes së energjisë do të kryhen me çdo formë të lejuar të komunikimit zyrtar të njohur dhe aprovuar nga legjislacioni në fuqi në RSH, duke përfshirë postën zyrtare, faksin, e-mailin etj”. Menyra e komunikimit do të jete e njejte per te gjithë.

Neni 13 - Procedura e vleresimit te ofertave

Ne baze te nevojës per blerje te energjise elektrike te percaktuar nga OSHEE sh.a. , Titullari i Autoritetit Bleres nxjerr Urdhrin per zhvillimin e procedures se blerjes se energjise elektrike. Ky urdher perben nje akt ekzekutiv te Titullarit te Autoritetit Bleres, qe percakton te dhena te karakterit tekniko-ekonomik te Blerjes se energjise elektrike si dhe percakton anetaret e komisionit qe do te kryeje zhvillimin e procedures se Blerjes. Komisioni eshte pergjegjes per zhvillimin e te gjithë procedures se blerjes se energjise elektrike.

Ky urdher duhet te permbaje:

- sasine e energjise elektrike ne MWh qe do te blihet;
- grafikun ditor te livrimit te energjise elektrike;
- siguruesin e kapaciteteve te transmetimit;
- kohezgjatjen e periudhes se livrimit te energjise elektrike;
- daten/oren e paraqitjes se ofertave;
- kriterin e vleresimit te ofertave;

- piken e livrimit te energjise elektrike;

Ne cdo rast, Titullari i Autoritetit Bleres mund te percaktoje ne kete urdher edhe kerkesa dhe kushte te tjera, kerkesa dhe kushte te cilat duhet qe te jene ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, perfshire dhe pa u limituar ne Kodin Civil te Republikes se Shqiperise.

Komisioni i blerjes se energjise elektrike nis ftesen per oferte, qe i drejtohet ne menyre te njekoheshme e te dokumentuar me e-mail te gjithë tregtareve te energjise elektrike te percaktuar si me lart ne kete rregullore.

Ftesa permban te pakten kerkesat e percaktuara ne nenin 9 te kesaj Rregulloreje. Kjo Ftese per Oferte publikohet ne faqen zyrtare elektronike te internetit te Autoritetit Bleres ne po te njejten dite qe ju drejtohet Tregtareve nga Autoriteti Bleres.

Brenda afatit te percaktuar ne ftesen per oferte, i cili ne cdo rast nuk duhet te jete me i shkurter se 24 ore pune per blerjet me periudhe livrimi te parashikuar prej me shume se dy ditesh, 4 ore pune per blerjet me periudhe livrimi te parashikuar prej me pak se dy ditesh dhe 2 ore ne rastet e blerjes se energjise elektrike ne kushtet e emergjences, Komisioni i Blerjes se energjise elektrike do te pranoje ofertat e Tregtareve pjesemarrës qe kane paraqitur Oferte,- Hapja dhe paraqitja e ofertave do te zhvillohen vetem ne ditet qe konsiderohen si dite pune ne Republiken e Shqiperise, pervec ne rastet e blerjes se energjise elektrike ne kushtet e emergjences.

Paraqitja e ofertave per shitje te energjise elektrike nga shoqerite ofertuese do te behet me nje zarf te mbyllur dhe/ose me email/faks, do te dorezohet/dergohet ne Autoritetin Bleres ne oren dhe daten e percaktuar ne ftesen per oferte. Komisioni i Blerjes se energjise hap/printon te gjitha ofertat qe jane dorezuar ne Autoritetin Bleres brenda afatit te percaktuar ne ftesen per oferte, ne prani te perfaqesueve te shoqerive ofertuese, dhe lexon per cdo oferte:

- Emrin e ofertuesit;
- Kapacitetin e ofruar/periudhe (MW);
- Sasine e ofruar/periudhe (MWh);
- Cmimin/njesi/periudhe (Euro/MWh);
- Vleren totale/periudhe (Euro);
- Profilin e livrimit per te gjithë periudhen kohore;
- Piken e livrimit te energjise elektrike;
- Vlefshmerine e ofertes;

3. Komisioni i Blerjes negocion me shoqërinë apo shoqëritë e përzgjedhura nga ky Komision pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave. Komisioni i Blerjes, në procesin me negocim do të komunikojë njëherazi brenda 24 orësh, me 5 shoqëritë që kanë paraqitur ofertat me çmimet/njësi më të ulëta apo me më shumë shoqëri deri në plotësimin e gjithë sasisë së kërkuar për blerje, duke pasur si kusht uljen e çmimit/njësi të paraqitur nga shoqëritë. Komisioni në ftesën për negocim do të përcaktojë afatin e pranimit të ofertave të negociuara i cili në cdo rast nuk do të jetë me pak se 4 ore pune nga marrja e ftesës për negocim.

4. Titullari i Autoritetit Bleres jo me vone se 24 ore pune nga marrja e raportit permbledhes, ne rast te miratimit prej tij, shpall oferten/ofertat fituese. Komisioni i Blerjes ka pergjegjesine per ruajtjen e konfidencialitetit te te gjitha ofertave te marra nga Tregtaret pjesemarrës ne procedure.

5. Brenda nje afati jo me shume se 24 ore pune, nga marrja e vendimit per shpalljen e oferte s/ofertave fituese, Autoriteti Bleres lidh kontratat perkatese. Nese ofertuesi fitues refuzon te lidhe kontraten per blerjen e energjise elektrike, atehere Autoriteti Bleres do te procedoje me negociimin per lidhjen e nje kontrate me ofertuesin e radhes, te kualifikuar.

6. I gjithë dokumentacioni shoqerues i te gjithë procedures se Blerjes se energjise se bashku me kontraten e lidhur midis Autoritetit Bleres dhe ofertuesit(ve) fitues, do te dokumentohet dhe ruhet sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni14 - Sqarimi dhe korrigjimi i ofertave

1. Per shqyrtimin, vleresimin dhe krahasimin sa me te drejte te ofertave te paraqitura nga ofertuesit, Autoriteti Bleres, kur e gjykon te arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime ose informacion lidhur me to.

2. Autoriteti Bleres korrigjon ato gabime ne oferte, qe jane thjesht te nje natyre aritmetike, nese gabimi nuk ndikon drejtpersedrejti ne kushtet dhe kriteret thelbesore te ofertes.

Neni15- Deklarata e konfliktit te interesave

Pas pranimit te ofertave, cdo anetar i komisionit do te nenshkruaje deklaraten, me ane te se ciles shpreh mungesen e konfliktit te interesave te tij me ofertuesit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Nese nje nga anetaret e Komisionit eshte ne kushtet e konfliktit te interesave me nje nga ofertuesit, atehere Kryetari i Komisionit do t'i kerkoje Titullarit te Autoritetit Bleres zevendesimin e tij. Deri ne emerimin e anetarit tjeter, Komisioni nuk do te procedoje me vleresimin e ofertave.

Neni16 - Njoftimi i fituesit dhe nenshkrimi i kontrates

Njoftimi i fituesit i jepet menjehere ofertuesit/ve, qe ka/kanë paraqitur oferten me te mire ne perfundim te procesit te vleresimit te ofertave. Njoftimi i fituesit permban te pakten:

- emrin, adresen e ofertuesit;
- periudhen e furnizimit me energji elektrike;
- profilin e furnizmit me energji elektrike;
- sasine, cmimin/njesi dhe vleren e kontrates;
- piken e livrimit te energjise elektrike;
- menyren e sigurimit te kapaciteteve te transmetimit/interkoneksionit;

Pas shpalljes se njoftimit te fituesit, Autoriteti Bleres dhe ofertuesi i shpallur fitues nenshkruajne kontraten.

Neni17 - Njoftimi i skualifikimit te ofertuesve

Njoftimi i skualifikimit te ofertave i/u jepet ofertuesit/ve, menjehere pas vleresimit perfundimtar te ofertave. Ky njoftim permban te pakten:

- emrin, adresen e ofertuesit;

- referencen e procedures se blerjes;
- objektin e procedures se blerjes;
- periudhen e furnizimit te energjise elektrike;
- daten e paraqitjes se ofertes;
- shkaku/shkaqet e skualifikimit;
- te dhenat baze mbi paraqitjen e mundeshme te ankeses.

Neni 18 - Anullimi i procedures se blerjes se energjise elektrike

Autoriteti Bleres mund te anulloje proceduren e blerjes se energjise elektrike per nje nga arsyet e mepostme:

- nuk eshte paraqitur asnje oferte brenda afateve kohore te paraqitjes se tyre;
- asnje nga ofertat e paraqitura nuk perputhet me kriteret dhe/ose kushtet tekniko-ekonomike, te percaktuara ne "Ftesen per oferte";
- per arsye te tjera te vertetueshme e te dokumentueshme, jashte kontrollit te Autoritetit Bleres dhe te paparashikueshme prej tij ne kohen e njoftimit apo zhvillimit te procedures se blerjes se energjise elektrike, ne interes te Autoritetit Bleres.
- ne rastet e anulimit te procedurave te blerjes se energjise elektrike per arsyet e percaktuara ne paragrafin 3 te ketij neni, Autoriteti Bleres informon hollesisht menjehere ERE per arsyet e anulimit.

Neni 19 – Publikimi ne faqen zyrtare te internetit (web-site) I procedures se blerjes

Brenda nje periudhe nje ditore pune nga perfundimi i procedures se blerjes se energjise elektrike, ne faqen elektronike te internetit te Autoritetit Bleres publikohen te dhenat e meposhme:

- Emrat e ofertuesve;
- Kapacitetet e ofruara te cdo oferte (MW);
- Sasite e ofruara te cdo oferte (MWh);
- Cmimin/njese te cdo oferte (Euro/MWh);
- Vleren totale te cdo oferte (Euro);
- Procentin e livrimit per te gjitha ofertat;
- Pikat e livrimit te energjise elektrike per cdo oferte;
- Vlefshmerine e te gjitha ofertave;
- Njoftimet e fituesve dhe/ose shoqerive jo-fituese;

Autoriteti Bleres publikon ne faqen e tij te internetit nje kopje te raportit permbledhes perfundimtar te shqyrtimit dhe vleresimit te ofertave, miratuar nga Titullari i Autoritetit Bleres.

Autoriteti Bleres publikon ne faqen e tij te internetit nje kopje te te gjitha ankesave te paraqitura, nese ka, si dhe kthimin eventual te pergjigjeve.

I gjithë informacioni i detyruar per tu publikuar, sipas dispozitave te kesaj rregulloreje, ne faqen e internetit te OSHEE sh.avdo te publikohet ne faqen e internetit te Autoritetit Bleres. '

Te gjitha informacionet do te publikohen ne gjuhen shqipe dhe angleze. Ne rast mosperputhjesh, informacioni ne gjuhen shqipe do te mbizoteroje.

Autoriteti Bleres do te mirembaje faqen e internetit dhe i gjithë informacioni i publikuar duhet qe te jete lehtesisht i aksesueshem nga te gjithë pjesemarresit e tregut.

Neni 20- Procedura e ankimit administrative

1. Cdo ofertues mund te kerkoje rishikim administrativ te procedures se ndjekur per nje blerje, kur gjykon se nje vendim i Autoritetit Bleres eshte marre ne kundersizim me kete rregullore, duke ndjekur hapat e meposhtem.

2. Ofertuesi i paraqet me shkrim (me poste, e-mail ose dorazi/me protokoll), Titullarit te Autoritetit Bleres, brenda 24 oresh pune nga momenti i njoftimit te skualifikimit ose shkeljes se pretenduar, ankesen perkatese. Ne kete ankesë, ankimesi duhet te referoje emrin dhe adresen, referimin per proceduren konkrete ku ka marre pjese, bazen ligjore dhe pershkrimin e shkeljes se pretenduar. Me marrjen e ankeses si me siper, Titullari i Autoritetit Bleres pezullon vazhdimin e procedures se blerjes ne fjale, derisa ankesa te jete shqyrtuar plotesisht dhe ky shqyrtim te jete shprehur ne formen e nje vendimi te shkruar nga Titullari i Autoritetit Bleres, i cili i dergohet ankimesit (me poste, fax, e-mail ose dorazi/me protokoll), brenda 24 oresh pune nga marrja e ankeses. Ankesa shqyrtohet nga nje komision, i cili konstituohet nga Titullari i Autoritetit Bleres, ne perberje te te cilit nuk do jete asnje nga personat e perfshire ne komisionin e percaktuar ne piken 1 të nenit 13 te kesaj Rregulloreje.

3. Ne cdo rast te paraqitjes se nje ankesë, Titullari i Autoritetit Bleres eshte i detyruar te shprehet me vendim per pranimin, apo refuzimin e ankeses.

4. Kur subjekti nuk eshte dakord me trajtimin e ankeses nga Titullari i Autoritetit Bleres, brenda 5 diteve pune i drejtohet ERE per zgjidhjen e mosmarrveshjes.

5. Kur subjekti nuk eshte dakord me trajtimin e ankeses nga ERE, i drejtohet gjykates per zgjidhjen e mosmarrveshjes.

Neni 21 - Monitorimi i blerjes se energjise elektrike

1. Te gjitha operacionet e blerjes se energjise elektrike do te dokumentohen me saktësi. Asnje blerje nuk do te kryhet pa dokumentacionin shoqerues te kerkuar i cili ne cdo rast do te mbahet edhe ne gjuhen shqipe.

2. Deri ne daten 5 te cdo muaji, titullari i Autoritetit Bleres paraqet ne ERE nje kopje te raportit permbledhes perfundimtar te shqyrtimit dhe vleresimit te ofertave, miratuar nga Titullari i Autoritetit Bleres, si dhe nje kopje te te gjitha ankesave te paraqitura, nese ka, si dhe kthimin eventual te pergjigjeve.

3. Autoriteti Bleres ka detyrimin qe t'i jape ne menyre transparente ERE-s te gjithë dokumentacionin e kerkuar prej saj, per blerjet e energjise elektrike ne kuader te autoritetit te ERE per te monitoruar Autoritetin Bleres.

Neni 22 - Rishikimi

Keto Rregulla jane objekt rishikimi me vendim te Bordit te ERE-s, sipas Rregullave te

Praktikes dhe Procedurave te ERE-s.

Neni 23 - Sanksione

Per shkeljen e ketyre rregullave, kur nuk perben veper penale, ERE vepron ne perputhje me nenin 107, te Ligjit Nr. 43/2015, date 28.05.2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, te ndryshuar.

Neni 24 - Hyrja ne fuqi

Kjo Rregullore hyn ne fuqi menjehere dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.